

## STUDIM

### Përtshtatja e kultivarëve të mandarinave ndaj kushteve ekologjike në koleksionin e bazës eksperimentale Shamogjin

**Qëllimi** : Të promovojmë kultivarët më të mirë dhe tua rekomandojmë fermërve si dhe ti furnizojmë ata me material shumezues cilsor.

Koha e zbatimit : Janar- dhjetor 2015.

Metodika e përdorur:

Manderinat klasifikohen në tre grupe: Grupi **klasik** ato që ne i quajmë Manderinë, grupi **Amerikan**(Satsuma,unshiu) dhe grupi i **zakonshëm** (Klementina dhe Tanxherina). Ky klasifikim përfshin manderinat dhe hibridet e tyre. Tanxherina është hybrid i manderinës me portokallin ndërsa klementinat janë hibride midis manderinës dhe nerenxës.Aktualisht tanxherinat janë bashkuar në një varjetet manderine, ndërsa klementinat konsiderohen si specie e vecantë.Megjithatë nuk është bërë ende një klasifikim përfundimtar i manderinave.

Në koleksionin e mandarinave në bazën eksperimentale Shamogjin janë kultivarët kryesor të cilët përfaqësojnë të tre grupimet e mësipërme shartuar mbi katër nënshartesa të ndryshme.U morën në studim pothuaj të gjithë kultivarët mbi nënshartesat përkatëse sipas skemës më poshtë.

	Kultivari	Nënshartesa		Kultivari	Nënshartesa
	Clementina	Nerenxe		Hernandina	Trifoljat
	Clementina	Troyer		Tangelo Novo	Nerenxe
	Clementina	carizo		Tangelo Novo	Troyer
	Clementina Comune	Nerenxe		Spinosa IAM-UBA	Nerenxe
	Clementina Comune	Troyer		Spinosa IAM-UBA	Troyer
	Clementina SRA 63	Trifoljat		Satsuma Myagaëa	Nerenxe
	Clementina SRA 89	Troyer		Satsuma	Nerenxe
	Clementina SRA	Trifoljat		Avana Apireno	Troyer
	Clementina 15 A	Nerenxe		Avana Apireno	L.Volkamerian
	Clementina Corsica	Nerenxe		Avana Apireno	Së.Ciutrumelo
	Clementina	Troyer			

	a Corsica				
	Hernandina	Nerenxe			
	Hernandina	Carizo			
	Hernandina	Troyer			

Treguesit qe u morën në studim:

**1. Fenofazat,** gonxhimi dhe lulezimi, fillimi dhe përfundimi i tyre.

Duke u nisur nga periudha fillimit dhe përfundimit të ngonxhimit dhe lulezimit kultivarët mund ti grupojmë ne tre grupe:

Me ngonxhim dhe lulëzim te **hershëm** 4-10 prill dhe ku futen kultivarët :

Clementina komune/Troyer,Cl.Corsica/nerenx,Cl.Corsica/trifoljat.

**Të mesëm** nga 10-15 prill ku futen kultivarët: Clementina commune/Nerenx,Clementina Comune/Carizo,Clementina Corsica/Troyer,Hernandina mbi të katër nëshartesat, C.Carizo, Nerënx,trifoljat dhe C.Troyer,Satsuma Myagaëa/Nerenx dhe C.Carizo si dhe Tangelo Novo/Nerenx.

**Të vonë,** pas 15 prillit dhe është cultivari Avana Apireno mbi tre nëshartesat C.Troyer,L.Volcamerian dhe S.Citrumelo.

## 2.Fruti:

Pesha e frutit në gr,pesha e levore në gr,pesha e tulit gr,raporti tul/lëvore,diametri gjatsor dhe tërthor,përbërja kimike e frutit(% e sheqerit dhe aciditeti) .

Të gjithë keta tregues janë të permblodhur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Cultivari	Nëshartesa	Fruti gr	Lëvore gr	Tuli gr	Raporti Tul/lev%	D/gjat cm	d/terth cm	Sheqeri %	Acidi. %
1	Clementina	Nerenxe	50.8	10.3	40.5	3.93	4.5	4	10.8	1.23
2	Clementina	Troyer	52.6	13.5	39.1	2.89	4.6	4.7	11.3	0.97
3	Clementina	Carizo	62.8	15.2	47.6	3.13	4.4	4.9	10	0.9
4	Clementina Comune	Nerenxe	50.6	9.3	41.3	4.44	4.5	4	10.65	1.33
5	Clementina Comune	Troyer	45.8	11.9	33.9	2.84	4.1	4.5	10.6	0.9
6	Clementina SRA 63	Trifoljat	63.8	14.8	49	3.31	4.86	4.56	11.3	1.15
7	Clementina SRA 89	Troyer	58.25	14	44.25	3.16	4.87	4.3	11	1.15
8	Clementina SRA	Trifoljat	60.95	14.2	46.75	3.3	4.8	3.6	11.6	1.15
9	Clementina 15A	Nerenxe	51	10.4	40.6	3.9	4.6	4.1	11.7	1.2
10	Clementina Corsica	Nerenxe	66.2	16.9	49.25	2.9	5.1	8.7	10.2	0.95

1 1	Clementina Corsica	Troyer	61.7	13.3	48.4	3.63	4.9	8.4	10	0.82
1 2	Hernandina	Nerenxe	56.9	9.4	47.45	5.04	4.9	4.2	10.3	1
1 3	Hernandina	Carizo	46.6	12.7	33.9	2.66	4	4.5	13.2	1.2
1 4	Hernandina	Troyer	40	10.4	29.6	2.84	3.8	4.2	14	1
1 5	Hernandina	Trifoljat	93.2	22.3	70.9	3.17	5	4.6	11.4	0.8
1 6	Tangelo Novo	Nerenxe	79	19	60	3.15	5.8	5	12.4	1.5
1 7	Tangelo Novo	Troyer	54.5	12.3	42.2	3.43	5.2	4.9	11	1
1 8	Spinosa IAM- UBA	Nerenxe	70	16.25	53.7	3.3	4.8	4.5	11.7	1.2
1 9	Spinosa IAM- UBA	Troyer	66.2	12	54.2	4.51	4.7	4.4	11	0.74
2 0	Satsuma Myagaëa	Nerenxe	184	40.3	143.7	3.56	7.5	6.3	8.3	0.7
2 1	Satsuma	Nerenxe	67.8	15.7	52.8	3.36	4.9	4.1	10.5	1.56
2 2	Avana Apireno	Troyer	78.3	16.9	61.4	3.6	4.5	5.5	9.7	1.33
2 3	Avana Apireno	L.Volkame rian	94	20.3	73.7	3.6	7.8	6.2	10	1.17
2 4	Avana Apireno	Së.Ciutru melo	80.6	15.6	65	4.2	4.2	5.3	9.7	1.12

Në fotot më poshtë jepen pamje për formën e kurores, formën e frutit e parë në dy pozicione dhe me prejete tërthore si dhe gjeten me pjesën e sipërme dhe të poshtme të saj.



Satsuma Myagaëa

Clemantina Corsica

Tangelo Novo



Spinosa IAM-UBA



Clementina Comune



Hernandina




Avana Apireno



SRA 63



Clementina



Përsa i përket qëndryshmërisë ndaj dëmtuesve (Tënja minuese dhe Miza mesdhetare) klasifikohen me prekje mesatare ndaj tënjës minuese cv.SRA63,Hernandina,Tangelo Novo dhe Satsumat. Kultivarët e tjerë rezultojnë me prekje të lartë ndaj Mizës mesdhetare kultivarë shumë qendrueshëm (i pa prekur) është Avana Apireno, me qëndryshmëri të lartë janë dhe Satsumat, Me qëndryshmëri mesatare janë kultivarët Hernandina dhe Tangelo Novo, dhe me qëndryshmëri të ulët të gjitha Clementinat.

**Konkluzione:** Në përgjithësi të gjithë kultivarët e manderinave përshtaten mirë në kushtet klimatike dhe toksore të zonës së Shamogjinit. Me zhvillim jo të mirë paraqiten bimët cultivarit SRA 89. Përsa i përket treguesve thelbësor të frutit që janë % e sheqerit dhe aciditeti nga analizat rezulton si më poshtë:

Në grupin e clementinave ka % më të lartë sheqeri dhe aciditet të ulët ato mbi nëshartesën "Troyer", ndërsa Clementina SRA 63/Trifoljat, SRA 89/Troyer dhe SRA/Trifoljat, Clementina 15A/Nerenxë kanë % e sheqerit të lartë por edhe aciditet të lartë nga 1.15-1.2%. Në grupin e Hernandinave ajo mbi nëshartesën Troyer ka % më të lartë sheqeri (14%) dhe aciditet 1%. Gjithashtu me tregues të mirë janë dhe Tangelo Novo dhe vecanërisht ajo mbi Nerenxë me % sheqeri 12.5%.

**Rekomandime:** Që ky studim të jetë më i plotë mendoj që përsa i përket treguesve të frutit është shumë e nevojshme të meren në studim edhe katër tregues të tjerë sic janë: Ph, Vitamina C, Sasia lëngut dhe numri i farave në frut. Krahas studimit agrobilogjik të kultivarëve të portokallit për vitin 2016 do të përfshihen edhe treguesit e mësipërm në kultivarët e manderinave.

Specialist  
Dr Zaim veshaj  
Agr Lida lazaj